

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-1091/2

26.04.2024

K ë r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 33-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 26.04.2024 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10 .

Seancën e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamerr Klosi, Drenuse Dalipi, Valbona Adili Emini, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Laze Jaqimoski, , Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Argjent Asani, Valentina Llazaroska, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Ramazan Zulbeari, Fortesa Sejdini, Sibel Tufkegji, Migjen Zendeli dhe Agim Sadiku.

Në mungesë ishte këshilltari Abdulla Sejdini.

Në seancë morrën pjesë: Aneta Nasteska –Sekretare e komunës, Valdet Selimi, Lenqe Srbinoska, Arben Ristemi, Mite Dimitrioski dhe Fjolla Aliu-përfaqësues nga administrata lokale, si dhe përfaqësuesi i Rajonit Planor Jugperëndimor.

Kryetari i këshillit pyeti nëse dikush ka ndonjë vërejtje për Procesverbalin nga seanca e 32-të e mbajtur më datë 14.03.2024.

Përshkak se askush nuk e morri fjalën, Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Procesverbalin e seancës së 32-të të këshillit të mbajtur më datë 14.03.2024 dhe i njejtë u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (nuk ka), PËRMBAJTUR (nuk ka).

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

RENDI I DITËS

1. Propozim Vendimi për ndyshim të vendimit për ekzekutim të buxhetit.
2. Miratimi i Raportit Vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor jugperendimor dhe llogarive përfundimtare për vitin 2023.
3. Propozim Vendimi për dhënjen e shfrytëzimit të sendit të luajtshëm, pronë e Komunës së Kërçovës
4. Të ndryshme.

Kryetari i këshillit hapi diskutimin dhe mori fjalën:

Valentina Lazarevska- Informon se ka vërejtje në material për pikën e tretë të rendit të ditës. Në pjesën hyrëse të Vendimit është shkruar data e seancës së kaluar, ndërsa është dashur të shkruhet data e seancës së sotme. Po ashtu, në dispozitivin në Vendim thuhej se automjetet do të jepen në shfrytëzim të shkollave të mesme, por është dashur të thuhet për shkollat fillore.

Agim Saduku- -Bën të ditur se ka gabim teknik në nenin 2 të vendimit në pikën e tretë, në pjesën Shqip nuk është shënuar data në pjesën hyrëse dhe në nenin 1 në vend të shkollave të mesme është dashur të shënohen shkollat fillore. .

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim rendin e ditës të propozuar për seancën e sotme dhe i njejt i miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

1. PIKA E PARË: Propozim Vendimi për ndyshim të vendimit për ekzekutim të buxhetit.

Sekretari i Komunës - Njofton se lidhur me këtë Vendim, sipas Ligjit për pagat e funksionarëve, janë ndryshuar pikët nga 3.2 në 2.79.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendimi për ndyshim të vendimit për ekzekutim të buxhetit dhe i njehti u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë).PËRMBAJTUR (asnjë).

2. PIKA E DYTË: Miratimi i Raportit Vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor jugperëndimor dhe llogarive përfundimtare për vitin 2023.

Përfaqësuesi i Rajonit Planor Jugperëndimor- shpjegoi në detaje Raportin Vjetor dhe Llogarinë Vjetore. Bën me dije se Raporti Vjetor i Qendrës së Rajonit Planor Jugperëndimor është përgatitur në përputhje me Rregulloren e Punës së Ministrisë. Është paraqitur në mënyrë narrative dhe tabelare. Ai theksoi se këtij raporti i ka paraprirë Plani Aksionar që është dashur të zbatohet. Ka pasur disa marrëveshje me Qendrën Zvicerane për Zhvillim për realizimin e projekteve. Për vitin 2024 janë lidhur kontratat me Byronë për Zhvillim Rajonal, janë shpallur furnizime publike dhe aktivitete që kanë nisur në janar 2024. Kanë qenë 16 projekte dhe janë realizuar me agjencinë e Zvicrës.

Agim Sadiku – Ai ka kërkuar nëse ka mundësi që të sqarohet më hollësisht. Ai pyeti se pse ka më pak investime në rajonin lindor në krahasim me atë jugperëndimor dhe verilindor dhe të bëjë një krahasim me rajonet e tjera. Ai theksoi se komuna duhet të konkurrojë me projekte, të miratohen dhe të fillojë zbatimin e tyre. Ai kërkoi një shpjegim më të detajuar se ku jemi si rajon për këtë.

Përfaqësuesi i Rajonit Planor Jugperëndimor – Informon se shteti është i ndarë në 8 rajone planore, sipas ligjit të vitit 2007, dhe 1% e GDP-së është për rajon. Këshilli i rajonit planifikues vendos për 80-90 milionë. Por kjo është ndryshuar me ligjin e ri. BNJVL konsideron se ai 1% bëhet përmes kryetarëve të komunave dhe kjo ende nuk është bërë. Ishte e nevojshme të vendosej për këtë. Sipas Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, ne ishim në vendin e 4-5. Ai theksoi se në rajonet kufitare mjete mund të mbledhin vetëm komunat, e jo Qendra për planifikim rajonal.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Raportit Vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor jugperendimor dhe llogarive përfundimtare për vitin 2023, të cilat u miratuan me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

3. PIKA E TRETË: Propozim Vendimi për dhënjen e shfrytëzimit të sendit të luajtshëm, pronë e Komunës së Kërçovës

Sekretari i Komunës – bën me dije se Vendimi ka gabime teknike dhe do të merret me ndryshimet e dhëna nga këshilltarja. Ajo theksoi se në seancën e kaluar shkollave të mesme u janë dhënë dy furgona, tani është dashur t'u jepen licenca për to. Me këtë vendim u është dhënë shfrytëzimi i automjeteve edhe shkollave fillore. Ajo bën me dije se në nenin 2 të Vendimit duhet të jenë shkollat fillore e jo të mesme. Më pas, me nënshkrimin e marrëveshjes, do të përcaktohet se cilat shkolla fillore do t'i shfrytëzojnë automjetet.

Valentina Lazarevska - Pyet nëse dihet se cilat janë shkollat.

Sekretarja e komunës – bën me dije se tani gjithçka ka qenë për shkollat, e më pas me marrëveshje do të përcaktohet se cilat shkolla do t'i shfrytëzohen automjetet.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendimi për dhënjen e shfrytëzimit të sendit të luajtshëm, pronë e Komunës së Kërçovës dhe i njejt i miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

4. PIKA E KATËRT: Të ndryshme

Mihajlo Daniloski - Ai apelon dhe kërkoi nga sekretarja e Komunës dhe administrata kompetente që të zgjerohet ndriçimi rrugor në Drugovë, nga rruga kryesore deri në hyrje. Bëhej fjalë për disa vende, dhe ishte e nevojshme për arsye sigurie. Ai kërkoi që të bëhet kontroll në vend dhe të vendoset ndriçimi rrugor.

Meqenëse askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe kështu u shterë rendi i ditës për këtë seancë, Kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës e mbylli seancën e Këshillit në ora 10:45 minuta.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

Këshilli i Komunës së Kërçovës
Kryetar
Skender Xhabiri d.v.

Përkthyes:Tefik Asani